



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

P/VENDIM

Nr. 21116 / Datë 15.12.2021


“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË, TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË”

Në mbështetje të nenit 8, nenit 24 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 38, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, pika 4/a VKM nr.362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit të Bashkisë:

PËR TË VENDOSUR:

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore në treg të lirë, sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Lezhë, si më poshtë vijon:
 - a) Qiraja për strukturën apartament për Garsionierë është 9 300 (nëntë mijë e treqind) lekë.
 - b) Qiraja për strukturën e apartamentit 1+1, është 13 000 (trembëdhjetë mijë) lekë.
 - c) Qiraja për strukturën e apartamentit 2+1, është 17 000 (shtatë mbëdhjetë mijë) lekë.
 - d) Qiraja për strukturën e apartamentit 3+1, është 20 500 (njëzetë mijë e pesëqind) lekë.
2. Vlera maksimale e subvencionimit të qirasë është e barazvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë projekt vendim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI
Pjerin NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi (lekë pa tvsh)	Çmimi (lekë pa tvsh)	Çmimi (lekë pa tvsh)	Çmimi mesatar (lekë pa tvsh)
				Lezha Real Estate	LORENA	ALBSOK 88Imobilare	
1	Banesa me qira (apartament-tip garsionerë)	1 muaj	1	11,000	9,000	8,000	9,300
2	Banesa me qira (apartament 1+1)	1 muaj	1	14,000	13,500	11,500	13,000
3	Banesa me qira (apartament 2+1)	1 muaj	1	21,000	14,000	16,500	17,000
4	Banesa me qira (apartament 3+1)	1 muaj	1	25,000	17,500	22,000	20,500



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Lezhë, me 15/12/2021

RELACION

PËR P/VENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË”

Në mbështetje të nenit 8, nenit 24 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 38, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, pika 4/a VKM nr.362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”,

Në kuadër të këtyre detyrmive dhe me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë në nevojë për strehim, përmes subvencionimit të qirasë si instrument i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet të cilat me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë, duhet të miratohet me vendim të këshillit bashkiak vlera maksimale e subvencionimit të qirasë siaps nenit 38 pika 1 e ligjit 22/2018 “ Për strehimin social”.

Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 362, datë 29.05.2019 “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, pika 4/a shprehet që për përcaktimin e vlerës së subvencionimit të qirasë në tregun e lirë duhet ndër të tjera të përcaktohet vlera mesatare e qirasë në tregun e lirë.

Sa më sipër, për të realizuar testimin e tregut janë kontaktuar 3 operatorë të regjistruar pranë organeve tatimore si subjekt që ofrojnë shërbime imobilare, dhe në bazë të këtij informacioni kemi llogaritur vlerat mesatare të qirave për territorin e Bashkisë Lezhë, sipas strukturave të apartamenteve, si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi (lekëpa tvsh)	Çmimi (lekë pa tvsh)	Çmimi (lekë pa tvsh)	Çmimi mesatar (lekë pa tvsh)
				Lezha Real Estate	LORENA	ALBSOK 88Imobilare	
1	Banesa me qira (apartament-tip garsionerë)	1 muaj	1	11,000	9,000	8,000	9,300
2	Banesa me qira (apartament 1+1)	1 muaj	1	14,000	13,500	11,500	13,000
3	Banesa me qira (apartament 2+1)	1 muaj	1	21,000	14,000	16,500	17,000
4	Banesa me qira (apartament 3+1)	1 muaj	1	25,000	17,500	22,000	20,500

Në këto kushte me qëllim përmbushjen e detyrimeve dhe ndjekjen e procedurave të nevojshme për zbatimin e programit të subvencionimit të qirasë në tregun e lirë, paraqesim për miratim këtë projekt-vendim: "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të qirasë mesatre në treg të lire.

KOMISIONI I STREHIMIT

1. Eueda Molla

2. Mareta Fetaj

3. Zukena Velkani

4. KURBAN LAGI

5. Denis Fardes

6. _____

7. Zef Lleshi